

Vendim nr. 138 datë 21.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (F) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATBARDHA PETERÇI, HASAN ROQI, LULJETA ROQI, SANTA ROQI**

OBJEKTI: Detyrimi i Gjykatës Kushtetuese të respektojë orientimin e dhënë nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, si shembull rasti Qufaj Co sh.p.k. për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, në raste të ngjashme, ku ka mungesë të dukshme të zbatimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në zbatim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar kërkohet ekzekutimi i vendimit të saj si pjesë e procesit gjyqësor. Me vendimin nr. 76, datë 08.11.2000 të Gjykatës Kushtetuese u la në fuqi vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë me investim të kërkesit në masën 37% në pjesën reale të pasurisë. Dispozita e ligjit, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 21.06.1993 (UKM nr. 3/1993) citon: “Kur vleftha e ndryshimeve del 20-50%, diferenca mbi 20% paguhet nga ish-pronari. Vetëm pasi paguan këtë kundërvleftë, objekti i kalon atij në pronësi. Afati i pagimit të kundërvleftës është 1 vit, në të kundërt objekti mbetet në bashkëpronësi.”. Pagesa e

kundërshtëpërblimit nga personat e interesuar është bërë pas 11.5 vjetësh. Dispozitën ligjore si më sipër nuk mund ta interpretojë, ndryshojë apo shkelë asnjë dispozitiv gjyqësor i asnjë gjykate, pasi shkel pavarësinë e pushteteve, parashikuar në nenin 7 dhe nenin 145, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*). Vendimi i mësipërm, në shkelje të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka 22 vjet e 6 muaj pa u ekzekutuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka dhënë vendimin përfundimtar nr. 76, datë 07.11.2000.

Detyrimi i Gjykatës Kushtetuese të ekzekutojë vendimin e saj nr. 76, datë 08.11.2000 për të drejtat e investimit të kërkuarve, njohur nga dispozita ligjore bashkëpronar në masën 37% të pasurisë, të shpallur në pjesën arsyetuese të vendimit të saj, si investitor në objekt e shtesa, i cili as mund të diskutohet ose interpretohet keqdashësisht.

Urdhërimi i regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të këtij investimi dhe lëshimi i certifikatës në emër të kërkuarve, sipas dispozitivit dhe ekspertizës së vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Detyrimi i Gjykatës Kushtetuese që për zgjatje tej afatit të arsyeshëm të procesit gjyqësor pa shkak, për mosekzekutim të vendimit të saj nr. 76, datë 08.11.2000, si pjesë përmbyllëse e procesit gjyqësor, të dëmshpërblejë kërkuarët në masën 100,000 lekë për çdo vit vonese ekzekutimi, në shumën 22.5 vjet x 100,000 lekë në vit = 2,250,000 lekë.

Nisur nga grabitja e banesës së kërkuarve nga personi *non grata* dhe strukturat në shërbim të tij në pushtet e gjykata, ku u falsifikua certifikata e paligjshme e pronësisë, në dobi

të personave të interesuar, në dhunim të vendimit të parë të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 76, datë 08.11.2000 i Gjykatës Kushtetuese dhe ligjin mbi të cilin ato kanë dalë, duke konstatuar dhunimin arbitrar me ashpërsi të papranueshme në shkelje të neneve 11, pika 2, 15, pikat 1 dhe 2, 18, pikat 1, 2 dhe 3, 25, 37, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pikat 1 dhe 2 dhe 44 të Kushtetutës dhe neneve 6, pika 1, 8, pika 1, 13, 14, 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të saj, nga gjykatat e faktit dhe të ligjit kërkojmë shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 9405, datë 09.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 2029, datë 06.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 315, datë 01.02.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe pushimin e gjykimit. Kthimin e kërkuësve në gjendjen e mëparshme, para dhënies së vendimeve të “Lirim dorëzim sendi”, duke urdhëruar riparimin e dëmeve të bëra në objekt e shtesa nga personat e interesuar në zbatim të urdhrave për shkatërrim të pronës nga ish-nënkryetari i minibashkisë nr. 10, z. E.K., i interesuar nga pushteti *non grata*, për të ndërtuar aty, pas dhunimit kriminal të kërkuësve, aktualisht i kallëzuar, në ndjekje penale në Gjykatën e Lartë.

Mbështetur në nenin 44 të Kushtetutës, nenin 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, caktimin në pjesën urdhëruese nga Gjykata Kushtetuese të organit të ngarkuar me zbatimin e vendimit të saj nr. 76, datë 08.11.2000, mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit, duke caktuar me ekspertët e njohur prej saj shpërblimin e dëmit moral e material dhe shpenzimet gjyqësore nga

vendimmarrja e paligjshme, antikushtetuese dhe antikonventore në çështjen “lirim dorëzim sendi”, si detyrë e Gjykatës Kushtetuese për të vënë në vend dinjitetin dhe autoritetin e saj, dinjitetin dhe autoritetin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dinjitetin dhe autoritetin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të kërkuessve viktime të shkelur, përdhosur e vjedhur nga administrata, gjykata e faktit dhe e ligjit si vijon: për dëmin moral, pagesën e qirasë së banesës, parkimit, dyqanit që nga dita që u nxorën me dhunë kriminale të autoriteteve të pushtetit familja e kërkuessve, sipas normativave shtetërore për 136 muaj. Totali i dëmit material “qiraja”: $136 \text{ muaj} \times 42,879.6 \text{ lekë/muaj} = 5,831,625.6 \text{ lekë}$. Shpërblimi moral për anëtarët e familjes Roqi 5 anëtarë nga 10,000 lekë/muaj, nga dita që u nxorën nga banesa antikushtetutshmërisht, si vijon: për të ndjerën M.R. deri në ditën e vdekjes datë 02.12.2017, 71 muaj e 20 ditë; për të ndjerin S.R. deri në ditën e vdekjes datë 29.04.2018, 76 muaj; për kërkuessin Hasan Roqi 136 muaj; për kërkuessen Luljeta Roqi 136 muaj; për kërkuessen Santa Roqi 136. Totali i dëmit moral $555.66 \text{ muaj} \times 10,000 \text{ lekë/muaj} = 5,556,600 \text{ lekë}$; shpenzimet për të gjitha proceset gjyqësore të ngritura për të mbrojtur të drejtat e vendimit të parë të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997, lënë në fuqi nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 76, datë 08.11.2000, në shumën 900,000 lekë.

Detyrimi i Gjykatës Kushtetuese, si kreu i ruajtjes dhe mbrojtjes së rendit juridik dhe Kushtetutës, të shpalosë me të gjithë forcën e saj fuqinë që i jep neni 124, pika 2, e Kushtetutës, të largojë nga sistemi garancinë e mosndëshkueshmërisë së korrupsionit, duke çuar para drejtësisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë grupin e strukturuar në sistemin e drejtësisë dhe administratë, i cili me forcën e imunitetit, në shpërdorim të detyrës shkelin

ligjin, vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke vjedhur banesën e kërkuësve. Të respektojë postulatet “Askush nuk është mbi ligjin” dhe “Drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar”, duke nxjerrë nga xhepat e shkelësve shpërblimin e dëmit dhe jo nga xhepat e taksapaguesve shqiptarë. Mbështetur kjo kërkesë në fjalinë e fundit të nenit 31/c dhe nenin 81, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000. Të vërë në vend të drejtën që buron nga vendimi nr. 76, datë 08.11.2000 i Gjykatës Kushtetuese dhe të ligjit të sigurt juridikisht, mbi të cilin ka dalë ai vendim, duke respektuar nenet 6, pika 1 dhe 8, pika 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në kuadër të një procesi të rregullt gjyqësor, besueshmërisë së Gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në procesin e kërkuësit, për të hequr çdo lloj dyshimi në këtë element të së drejtës, kërkoj përjashtimin nga ky gjykim të gjyqtarëve të vendimeve të Mbledhjes së gjyqtarëve nr. 81, datë 22.06.2021, nr. 111, datë 28.09.2021, nr. 81/1, datë 28.09.2021; personave të interesuar në vendimet në vendimet nr. 2, datë 24.01.2022 dhe nr. 3, datë 25.01.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; gjyqtarëve të vendimit nr. 177, datë 09.12.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ku të drejtat ligjore e kushtetuese të kërkuësit janë cenuar arbitrarisht, në goditje të rëndë të Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe juridiksionit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 5, 7, 11, pika 2, 15, pikat 1 dhe 2, 18, pikat 1 dhe 2, 25, 33, pika 1, 37, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pikat 1 dhe 2, 44, 81, pika 2, shkronja “d”, 100, pikat 4 dhe 5, 107, pika 1, 116, pika 1, 117, pika 1, 118, pikat 1, 2 dhe 3, 122, pika 2, 124, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pikat 1 dhe 2, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141, pika 1, 142, pikat 1 dhe 3 dhe 145 të

Kushtetutës; nenet 6, pika 1, 8, pika 1, 13, 14 dhe 41, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 1, pika 2, 26, pikat 1 dhe 2, 27, 31/c, fjalë e fundit, 36, 37, 39, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, 43/b, pikat 1 dhe 2, 71, 71/a, pikat 1 dhe 2, 71/ç, pikat 1, 2, 3 dhe 4, 76, pikat 1 dhe 3, 81, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi S.R. (trashëgimlënësi i kërkuarve Hasan Roqi dhe Fatbardha Peterçi) ka banuar qiramarrës kryesor në disa ambiente në katin e parë të një banese shtetërore dykatëshe, të ndodhur në rrugën “Mujo Ulqinaku”, nr. 33, Tiranë, ngjitur me të cilën, në vitin 1990, me shpenzimet e veta, ka bërë disa shtesa anësore (dhomë, kuzhinë etj.).

2. Me vendimin nr. 314, datë 11.04.1994 (*vendimi nr. 314/1994*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Tiranë, pika 1 e tij, është miratuar kërkesa e ish-pronarit Xh.K. për kthimin e kësaj banese dykatëshe dhe disa ambienteve të tjera në oborrin e saj. Në pikën 2 të vendimit, *KKKP*-ja është shprehur se vlera e shpenzimeve të shtesës anësore, ndërtuar ngjitur me banesën, përbën 11,7% të vlerës së banesës, pra është nën 20%, ndaj kjo shtesë i kthehet ish-pronarit Xh.K pa kundërshtim, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (*ligji nr. 7698/1993*).

3. Për rrjedhojë, shtetasi S.R. i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 314/1994 të *KKKP*-së dhe njohjen e pronësisë mbi shtesat. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1666, datë 16.04.1997, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Mbi ankimin e shtetasit S.R., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2227, datë 08.10.1997, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1666, datë 16.04.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, duke gjykuar çështjen në fakt, ka

pranuar pjesërisht padinë, duke ndryshuar pikën 2 të vendimit të KKKP-së në lidhje me vlerën e shpenzimeve të kryera nga paditësi S.R., duke i njohur ato në masën 37%, që përkonte me vlerën 286,890 lekë të kontributit të tij në pjesën që përdorte në raport me ndërtesën e ish-pronarit. Gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KKKP-së për pjesët e tjera. Ky vendim i gjykatës së apelit është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 489, datë 26.03.1998. Me vendimin nr. 17, datë 09.02.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur mospranimin e rekursit në interes të ligjit të paraqitur nga S.R.

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme, e cila, me vendimin nr. 76, datë 08.11.2000, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

5. Mbi bazën e kërkesës së shtetasit S.R., si dhe të një prej trashëgimtarëve të ish-pronarit Xh.K., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrat e ekzekutimit të vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Secili prej këtyre shtetasve i është drejtuar në vijim Zyrës së Përmbarimit Shtetëror, Tiranë për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor titull ekzekutiv. Shtetasi S.R. ka kërkuar regjistrimin e tij si bashkëpronar i banesës në bazë të UKM-së nr. 3/1993, dalë në zbatim të ligjit nr. 7698/1993, për sa kohë vlera e ndryshimeve në shtesat anësore të banesës, sipas vendimit gjyqësor, ka rezultuar 20-50%, ndërkohë që ish-pronari nuk ka paguar brenda një viti detyrimin për to. Pas një korrespondence me ZVRPP-në, Tiranë, përmbaruesi gjyqësor ka refuzuar kryerjen e veprimeve përmbarimore, me arsyetimin se vendimi gjyqësor ishte i paqartë dhe se kreditori S.R. duhet të bënte sqarimin dhe interpretimin e tij. Mbi të njëjtat argumente, përmbaruesi gjyqësor ka refuzuar edhe kërkesën për ekzekutim të paraqitur nga trashëgimtari i ish-pronarit Xh.K. Në këto kushte, ai ka kërkuar nga Gjykata e Apelit Tiranë interpretimin e vendimit të saj nr. 2227, datë 08.10.1997, kërkesë që është rrëzuar me vendimin e saj nr. 28, datë 02.03.2010, me arsyetimin se vendimi është i qartë për sa i përket vlerës së punimeve të pretenduara nga paditësi S.R, që, në rastin konkret, konsiderohet si detyrim për t'u përmbushur nga palët e paditura, trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K.

6. Pas këtij vendimi gjyqësor, trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K., në datën 29.03.2010 kanë derdhur në llogarinë bankare të Zyrës së Përmbarimit Shtetëror, Tiranë vlerën 286,890 lekë në favor të shtetasit S.R. Më tej, në datën 20.04.2010 ZVRPP-ja, Tiranë ka lëshuar në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit certifikatën e vërtetimit të pronësisë për pasurinë ndërtesë dhe truall.

7. Edhe shtetasi S.R. i është drejtuar ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin e vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pra për regjistrimin e tij si bashkëpronar, mbi argumentin e përshkruar në paragrafin 3 të këtij vendimi. ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresat e datave 20.07.2010, 18.10.2010 dhe 27.10.2010, i ka kthyer përgjigje duke i bërë të ditur se kërkesa e tij për regjistrimin e vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ishte e pambështetur, pasi në emrin e tij nuk rezultonte asnjë pasuri e regjistruar dhe se pranë saj nuk ishte depozituar asnjë vendim gjykate që përbënte titull pronësie në favor të tij. Sipas ZVRPP-së, Tiranë, vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk anulonte vendimin nr. 314/1994 të KKKP-së, por njihte vetëm shtesat anësore të bëra në vlerën 37% të kontributit, vlerë për të cilën S.R. ishte kundërshtëpërblyer nga ish-pronari sipas ligjit, ku mbi këtë bazë, pas depozitimit të dokumentacionit përkatës, për trashëgimtarët e këtij të fundit ishte lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie.

8. Shtetasi S.R. ka aplikuar për legalizimin e ndërtimit pa leje në bazë të ligjit nr. 9842, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Në përgjigje të këtij aplikimi dhe pas një ankese nga aplikuesi, me shkresën nr. 2105/3 prot., datë 15.06.2010, Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t e ka njoftuar atë mbi moskualifikimin e objektit të vetëdeklaruar për legalizim, me arsyetimin se pas marrjes së konfirmimit zyrtar nga ZVRPP-ja, Tiranë për statusin juridik të objektit kryesor dhe truallit të tij, rezultonte se subjekti vetëdeklarues i shtesës informale nuk gëzonte asnjë të drejtë pronësie për objektin kryesor dhe as nuk kishte aktmarrëveshje me pronarin e truallit.

9. Në vijim, sipas shkresës nr. 1390 prot., datë 04.06.2010 të Entit Kombëtar të Banesave (EKB), mbështetur në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane” dhe në aktin normativ nr. 3/2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara” (miratuar me ligjin nr. 82/2012), si dhe të udhëzimit të ministrit të Financave dhe ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 6257, datë 02.09.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, S.R., si qiramarrës në banesë ish-pronë private, i është akorduar një kredi e subvencionuar nga shteti në masën 80 % të vlerës së apartamenteve në treg, për një periudhë prej 30 vjetësh, me interes 0%.

10. Trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K., pas pajisjes me certifikatën e pronësisë, i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi, pjesa nga banesa që ndodhet në rrugën “Mujo Ulqinaku”, me palë të paditura S.R., M.R., Hasan Roqi, Luljeta

Roqi dhe Santa Roqi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9405, datë 09.12.2010, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e të paditurve Roqi të lirojnë dhe dorëzojnë ambientet e banimit që posedojnë në shtëpinë e banimit, pronë e paditësve, të regjistruar në emër të tyre në ZVRPP. Kundër këtij vendimi kërkuessit kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 2029, datë 06.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm. Bazuar në kërkesën e paditësve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6574, datë 16.11.2011, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 9405, datë 09.12.2010 dhe është vënë në lëvizje procedura e ekzekutimit të detyrueshëm. Në lidhje me rekursin e paraqitur nga pala e paditur në proces, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1736, datë 04.07.2014 të Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e tij.

11. Kërkuessit kanë paraqitur kërkesë në Gjykatë, për të cilën, me vendimin nr. 16, datë 10.03.2016, është vendosur: *“Pranimi pjesërisht i kërkesës. Shfuqizimi i vendimit nr. 1736, datë 04.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate. Rrëzimi i kërkesës për pretendimet e tjera.”*. Gjykata ka gjetur të bazuar pretendimin e për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, ndërkohë që në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuessve, për cenimin e parimit të sigurisë juridike, së drejtës së pronës, parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka vlerësuar të mos i analizojë për sa kohë çështja do të merrej përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

12. Kërkuessit kanë iniciuar në gjykatë edhe disa procese të tjera gjyqësore. Në lidhje me padinë me objekt konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 314/1994 të KKKP-së, zgjidhjen e pasojave dhe fshirjen e regjistrimit të këtij vendimi nga ana e personit të tretë, me vendimin nr. 8996, datë 03.10.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë. Mbi bazën e ankimit të shtetasit S.R., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2610, datë 10.12.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kurse në lidhje me rekursin, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2022-1709, datë 11.04.2022, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Në lidhje me këtë proces gjyqësor kërkuessit kanë paraqitur edhe ankim kushtetues, për të cilin Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës, me vendimin nr. 177, datë 09.12.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

13. Po kështu, kërkuessit i janë drejtuar edhe gjykatës administrative me padi me objekt shfuqizimin (anulimin) tërësisht të aktit “certifikatë për vërtetim pronësie”, datë

20.04.2010 të ZVRPP-së, Tiranë për llojin e pasurisë truall me sipërfaqe 668 m², nga e cila 167 m² ndërtesë me nr. pasurie 3/145 në rrugën “Mujo Ulqinaku”, detyrimin e ZVRPP-së të pasqyrojë shfuqizimin e këtij akti në regjistrat përkatës, detyrimin e ZVRPP-së të pasqyrojë në regjistrat përkatës vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 2227, datë 08.10.1997 dhe anulimin e ndarjes së përgjithshme të truallit në dy sipërfaqe prej 636 m² dhe 32 m², certifikatave të vërtetimit të pronësisë dhe çdo kufizimi të vendosur mbi to, si dhe kontratës së sipërmarrjes të datës 22.04.2014. Në lidhje me këtë çështje, me vendimin nr. 2998, datë 13.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesëpadisë, konstatimi i paligjshmërisë së veprimit administrativ të ZVRPP-së për lëshimin e certifikatës për vërtetim pronësie të datës 20.04.2010, në emër të personave të tretë, shfuqizimin e veprimeve administrative të ZVRPP-së mbi pasurinë nr. 3/145 për ndarjen e sipërfaqes së përgjithshme të truallit në dy sipërfaqe prej 636 m² dhe 32 m², si dhe konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ për lëshimin e certifikatave të vërtetimit të pronësisë, detyrimin e ZVRPP-së të pasqyrojë sa më sipër në regjistrat dhe kartelat përkatëse të pasurive. Në lidhje me pjesën tjetër të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur rrëzimin. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 106 (86-2023-137), datë 07.02.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Ndërkohë, në lidhje me procesin gjyqësor të kthyer për rigjykim në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës, me vendimin nr. 00-2023-315, datë 01.02.2023, Kolegji Civil, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban asnjërin nga rastet e parashikuara në ligj.

15. Me kërkesën e datës 13.04.2023 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit të mësipërm.

II

Pretendimet e kërkuessve

16. **Kërkuessit** kanë pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjyqimit është cenuar:

- 16.1. *Parimi i sigurisë juridike i lidhur me të drejtën e pronës private*, pasi vendimi nr. 9405, datë 09.12.2020 i gjykatës së shkallës së parë nuk ka respektuar nenin 12 të KPC-së në shkelje të nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës, që lidhet me barrën e provës nga ana e palës paditëse që pretendonte lirim e dorëzim sendi bazuar mbi një certifikatë të paligjshme me të dhëna të

falsifikuara. Për rrjedhojë, nuk janë respektuar kërkesat e vendimit unifikues nr. 1, datë 06.01.2009 (nr. 1/2009), i detyrueshëm nga gjykatat e faktit, që për padinë e rivendikimit kërkonte dokumentin origjinal të fitimit të pronësisë, të cilin paditësit nuk e kanë pasur asnjëherë dhe nuk e kanë as sot. Arsyetimi se padia e njohjes bashkëpronar është rrëzuar nga gjykatat në vitin 2010, është i gënjeshtërt dhe nuk është respektuar neni 141 i Kushtetutës. Gjykatat nuk kanë pranuar të verifikojnë vërtetësinë e certifikatës së paligjshme dhe të paditurit në procesin gjyqësor (kërkuesit) në asnjë rast nuk u dëgjuan në lidhje me argumentet e tyre. Kjo certifikatë binte në kundërshtim me dispozitivin e vendimit të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i lënë në fuqi nga Gjykata Kushtetuese, dhe me dispozitat e UKM-së nr. 3/1993 që përcaktojnë se afati i pagimit të kundërvleftës është 1 vit, ndërsa pagesa e dëmshpërblimit nga personat e interesuar është bërë pas 11.5 vjetësh. Vendimi i formës së prerë i gjykatës së apelit, i lënë në fuqi nga Gjykata Kushtetuese, nuk është respektuar në kundërshtim me nenin 451/a të KPC-së.

- 16.2. Për shkak të mospagimit të kundërvleftës brenda afati prekluziv të përcaktuar nga UKM-ja nr. 3/1993, kërkuesit janë bërë bashkëpronarë, por gjykatat e kanë pranuar të ligjshme shkeljen e këtij afati parashkrues. Vendimi i KKKP-së nr. 314/1994, që përbën titull ekzekutiv, është ndryshuar nga një titull tjetër ekzekutiv, sipas nenit 510, shkronja “a”, të KPC-së, që është vendimi i formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi pikën 5 të vendimit të KKKP-së, duke urdhëruar regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). Asnjë nga vendimet gjyqësore nuk është shprehur që kundërshtëpërblimi nga familja Kadesha të paguhet tej afatit 1-vjeçar. As vendimet gjyqësore, as pika 9, shkronja “ç”, e UKM-së nr. 3/1993 nuk kanë urdhëruar që ZVRPP-ja dhe Zyra e Përmbartimit pjesën prej 37% të familjes Roqi t`ia kalojnë në pronësi të familjes Kadesha pas pagesës së tyre tej afatit 1-vjeçar. As nuk kanë urdhëruar që truallin prej 668 m<sup>2</sup> pronë shtetërore, të pashtetëzuar dhe të panjohur nga organet e caktuara me ligj, t`ia dhurojnë familjes Kadesha pa asnjë kundërshtëpërblim, bashkë me sipërfaqen prej 205 m² të njohur kërkuesve nga ekspertiza e gjykatës. Ato nuk kanë urdhëruar që familjes Roqi t`i akordohej kredi kur vendimet e Gjykatës kërkonin që familjeve me banim në banesa ish-pronë private t`u privatizohej ajo në kushte të barabarta me qytetarët e tjerë. Këto vendime janë në hierarki

mbi aktet e organeve të tjera, por nuk janë marrë parasysh nga gjykatat, në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës. Fakti i të qenit bashkëpronar në 37% të pronës është përfundimtar dhe i sigurt juridikisht si nga pikëpamja ligjore, ashtu edhe kushtetuese. Për rrjedhojë, arsyetimi i gjykatave në padinë e rivendikimit është haptazi i pabazuar.

- 16.3. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për verifikimin e origjinës së pronës, kufijve të saj, regjistrimit të paligjshëm të sipërfaqes së truallit, si dhe nuk kanë pranuar mbrojtjen dhe prapësimin e kërkuësve për abuzimin e paditësve në ngritjen e padisë, kundërvajtjen e ASHK-së dhe shkeljen e procesit të rregullt. Vendimi i gjykatës së apelit nuk bazohet në provat e fashikullit gjyqësor dhe mungon hetimi i gjithanshëm i çështjes. Mungon kërkesa e analizës themelore vërtetimi i pronës së paditësve me dokument origjinal ose të prejardhur (kontratë), pasi paditësit as sot nuk disponojnë asnjë dokument pronësie për truallin dhe për godinën. Gjykata është ndodhur para dy titujve ekzekutivë, vendimit nr. 314/1994 i KKKP-së, që është nxjerrë në shkelje të UKM-së nr. 3/1993, dhe vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i formës së prerë, që e ka ndryshuar vendimin e KKPP-së, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit nuk ka shënuar në vendimin e saj vlerë monetare, por pjesë bashkëpronësie 37%, pasi pjesa e detyrimit prej 286,890 lekësh ishte shuar 25 muaj para vendimit të saj, i cili është i detyrueshëm për ekzekutim dhe regjistrim jo vetëm nga ASHK-ja, por dhe vetë Këshilli i Ministrave.
- 16.4. *E drejta e aksesit dhe e ankimit substancial në drejtim të së drejtës për t'ua dëgjuar*, pasi Kolegji Civil e ka gjykuar padinë në dhomën e këshillimit për vetëm 5 minuta nga ora 09:05 – 09:10. Relatorja e çështjes M.B. në të njëjtën ditë kishte 12 çështje dhe në total trupi gjykues ka shqyrtuar 32 çështje në dhomën e këshillimit nga ora 09:00 deri në orën 14:30. Ky limit kohor nuk respekton kërkesat e nenit 118 të KPC-së, pasi në këtë mënyrë nuk mund të arrihen kërkesat për plotësimin e procesverbalit.
- 16.5. *Standardi i arsytimit të vendimit i lidhur me të drejtën e pronës private*, pasi Gjykata e Lartë ka përdorur disa shprehje shabllon në vendimin e saj, pa i hyrë fare themelit të çështjes, pa kontrolluar ligjshmërinë e procesit të gjykatave të faktit, duke vënë në dyshim vërtetësinë dhe drejtësinë e procesit gjyqësor.

Gjykata e ligjit në padinë e rivendikimit ka pasur detyrimin për të konstatuar ose gjykuar vetë pavlefshmërinë e certifikatës të 12 vjetëve më parë, që kur është ngritur kërkesëpadia nga pjesëtarët e familjes Kadesha, dhe të konstatonte se ata nuk ishin pronarë të ligjshëm të pronës dhe se ZVRPP-ja ka shkelur ligjin për regjistrimin e saj, UKM-në nr. 3/1993 dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

- 16.6. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në kundërshtim me pretendimet e kërkuësve, duke mos i marrë ato në konsideratë dhe vetë ligjin, edhe pse rekursi ishte bazuar në nenin 472 të KPC-së. Pas kthimit të çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, kërkuësit paraqitën parashtrimet e tyre, duke pretenduar se ishin të pranishme kriteret ligjore për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke qenë se gjykatat e zakonshme nuk kanë realizuar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes në funksion të vërtetimit të rrethanave të faktit që lidhen me zgjidhjen e saj, nuk kanë marrë në analizë dhe nuk kanë çmuar vendimet e dhëna, një pjesë të provave shkresore të administruara në dosjen gjyqësore. Kërkuësit kërkuar pezullimin e gjykimit derisa të marrë formë të prerë gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit i paligjshmërisë së veprimit të ZRPP-së për lëshimin e certifikatës së pronësisë, e cila nuk u pranua. Po ashtu, u pretendua mosrespektimi i vendimit unifikues nr. 1/2009 në lidhje me padinë e rivendikimit, që i vinte detyrimin gjykatës të kërkonte nga paditësit Kadesha të provonin titullin e pronësisë mbi sendin, çka kërkonte domosdoshmërisht kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Referuar vendimit nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë kishte detyrimin të kontrollonte respektimin e standardeve të së drejtës për proces të rregullt në drejtim të parimit të sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme, barazisë para ligjit.
- 16.7. Gjykata duhet të vendosë edhe shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, pasi kërkuësve u janë cenuar interesa të ligjshëm personalë pasurorë e moralë nga veprimet e paligjshme të institucioneve shtetërore, si dhe të gjykatave të faktit e të ligjit në shqyrtimin e padisë së rivendikimit. Kërkesa për dëmshpërblimin e dëmit mbështetet edhe në dispozitat e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe nenet 18, pika 1, 2 dhe 3, 25 dhe 44 të Kushtetutës e nenet 13 dhe 14 të KEDNJ-së, pasi kërkuësit janë diskriminuar nga veprimet e padrejta të autoriteteve, personave të interesuar dhe të

gjykatave që kanë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese në trajtimin e barabartë të shtetasve në lidhje me të drejtën për banesë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

18. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

19. Kërkuessit, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohen *ratione personae* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike efektive nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të

rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesit i janë drejtuar Gjykatës, duke kundërshtuar procesin gjyqësor që është përmbyllur me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pas rikthimit të çështjes për rishqyrtim nga kjo Gjykatë me vendimin nr. 16, datë 10.03.2016. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se kërkesit e kanë plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi nuk kanë mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, përveç kërkesës në këtë Gjykatë. Në drejtim të këtij kriteri paraprak, në lidhje me pretendimet për procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e faktit, Kolegji thekson, gjithashtu, se ai nuk mund të marrë në shqyrtim pretendime të ngritura rishtazi në këtë ankim kushtetues, por vetëm ato që kanë qenë objekt i ankimit kushtetues të shqyrtuar më parë prej saj me vendimin nr. 16, datë 10.03.2016.

22. Kërkesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi i janë drejtuar Gjykatës me kërkesën e datës 13.04.2023 për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Civil të datës 01.02.2023. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

23. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesit, si shkaqe në mbështetje të kërtimeve të tyre të paraqitura në objekt të kësaj kërkesë, kanë pretenduar, në thelb, cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës private, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private. Kurse referuar objektit të kërkesës, ata kanë kërkuar, në mënyrë të përmblëdhur, detyrimin e kësaj Gjykate të ekzekutojë vendimin e saj nr. 76, datë 08.11.2000, urdhërimin e organeve shtetërore të lëshojnë certifikatën e pronësisë në emër të kërkesve dhe kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror për shkak të mosekzekutimit të vendimit të kësaj Gjykate dhe cenimit të interesave të tyre të ligjshëm personalë pasurorë e moralë nga veprimet e paligjshme të institucioneve shtetërore dhe gjykatave.

24. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë

juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 10, datë 03.04.2018; nr. 42, datë 25.05.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues (*shih vendimin nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Kolegji, në lidhje me kërkimet e parashtruara në objektin e kërkesës në shqyrtim, vëren se kërkuarit kanë kërkuar ekzekutimin e vendimit të Gjykatës nr. 76, datë 08.11.2000, që i ka njohur ata bashkëpronarë në masën 37% në pasurinë e paluajtshme objekt konflikti gjyqësor, si dhe urdhërimin e ASHK-së të regjistrojë këtë investim dhe të lëshojë certifikatën e pronësisë në emër të kërkuarëve. Gjykata ka theksuar se pretendimet e individit për moszbatimin e vendimeve të saj mund të përbëjnë një çështje të re në raport me atë tashmë të marrë në shqyrtim prej saj, nëse veprimet ose mosveprimet e organeve të ngarkuara për zbatimin e këtyre vendimeve krijojnë mosmarrëveshje kushtetuese. Kjo do të thotë se Gjykata nuk ka juridiksion të shqyrtojë thjesht masën ose mënyrën se si po zbatohet një vendim i saj dhe se ankimi kushtetues individual nuk mund të përdoret si mjet për kontrollin e kushtetutshmërisë së ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore jashtë kufijve të kompetencave të kësaj Gjykate (*shih vendimin nr. 20, datë 05.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuarëve në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi lidhet, në thelb, me të drejtën e pretenduar të bashkëpronësisë mbi objektin ku ka qenë qiramarrës trashëgimlënësi i tyre, shtetasi S.R., i cili nuk i takon sferës së çështjeve që shqyrtohen nga juridiksioni kushtetues, por i përket çështjeve që i përkasin juridiksionit të zakonshëm.

26. Kërkuarit kanë kërkuar, gjithashtu, shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, për shkak se u janë cenuar interesat të ligjshëm personalë pasurorë e moralë nga veprimet e paligjshme të institucioneve shtetërore dhe të gjykatave të faktit e të ligjit në shqyrtimin e padisë së rivendikimit. Sipas tyre, ata janë diskriminuar nga veprimet e padrejta të autoriteteve, personave të interesuar dhe të gjykatave që kanë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese në trajtimin e barabartë të shtetasve në lidhje me të drejtën për banesë. Kërkuarit kanë kërkuar edhe shpërblimin e dëmit nga Gjykata në zbatim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577/2000, për shkak të mosekzekutimit prej saj të vendimit nr. 76, datë 08.11.2000. Referuar kësaj dispozite, Kolegji vëren se ajo i referohet tejzgjatjes së procesit të shqyrtimit të ankimit kushtetues dhe i njeh të drejtën kujtëdo që është palë në këtë proces dhe pretendon se ai është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, të kërkojë shpërblim të drejtë nga Gjykata nëse konstatohet se nga tejzgjatja e procesit i janë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të parashikuara

nga Kushtetuta. Kolegji vëren se këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me procesin gjyqësor që është zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në drejtim të mënyrës së zgjidhjes së çështjes konkrete, të cilat i takojnë sferës së çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe nuk i përkasin juridiksionit kushtetues.

27. Kolegji vëren se kërkuessit kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar, pasi Kolegji Civil e ka gjykuar padinë në dhomën e këshillimit për vetëm 5 minuta nga ora 09:05 – 09:10. Sipas tyre, relatorja e çështjes M.B. në të njëjtën ditë kishte 12 çështje dhe në total trupi gjykues ka shqyrtuar 32 çështje në dhomën e këshillimit nga ora 09:00 deri në orën 14:30, limit kohor që nuk respekton kërkesat e nenit 118 të KPC-së, pasi në këtë mënyrë nuk mund të arrihen kërkesat për plotësimin e procesverbalit. Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues, duke mos arritur kërkuessit që të argumentojnë pasojën konkrete në drejtim të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, për shkak të mënyrës së organizimit të shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë.

28. Po kështu, edhe pretendimet e kërkuessve se Kolegji Civil nuk ka respektuar vendimin unifikues nr. 1/2009 në lidhje me padinë e rivendikimit, që i vinte detyrimin gjykatës të kërkonte nga paditësit Kadesha të provonin titullin e pronësisë mbi sendin, çka kërkonte domosdoshmërisht kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ka të bëjë, në thelb, me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit material, si dhe vlerësimin e provave të administruara në gjykim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës, por i takojnë juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

29. Kërkuessit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka pranuar kërkesën për pezullimin e gjykimit derisa të merrte formë të prerë vendimi nr. 2998, datë 13.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 106 (86-2023-137), datë 07.02.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji vlerëson se kërkuessit nuk kanë arritur të provojnë në nivel kushtetues cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese për shkak të këtij qëndrimi të Kolegjit Civil. Për më tepër, rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka parashtruar në vendimin e tij shkaqet për rrëzimin e kësaj kërkesë, duke arsyetuar se ai nuk ka të drejtë të bëjë rivlerësimin e provave ose të marrë prova të reja, ndërkohë që e drejta e palëve në rast të sigurimit të provave të reja në të ardhmen, qofshin këto edhe vendime gjyqësore, garantohet nëpërmjet mjetit procedural të jashtëzakonshëm të ankimit, që është kërkesa për rishikim të vendimit (*shih paragrafin 21 të vendimit*).

30. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara nga kërkuesit, konkretisht ato që kanë të bëjnë me cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës private, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private, Kolegji vlerëson se, duke qenë se kjo çështje është rigjykuar nga Gjykata e Lartë në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 10.03.2016, ato do të trajtohen në drejtim të respektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me standardin kushtetues të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të kësaj Gjykate.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkuesit kanë pretenduar, në thelb, se Gjykata e Lartë ka përdorur disa shprehje shabllon në vendimin e saj, pa i hyrë fare themelit të çështjes dhe pa kontrolluar ligjshmërinë e procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e faktit, ndërkohë që ka pasur detyrimin për të konstatuar ose gjykuar vetë pavlefshmërinë e certifikatës të 12 vjetëve më parë, në kohën kur është ngritur kërkesëpadia nga pjesëtarët e familjes Kadesha, dhe të konstatonte se ata nuk ishin pronarë të ligjshëm të pronës, si dhe se ZVRPP-ja ka shkelur ligjin. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse ai ishte bazuar në nenin 472 të KPC-së, dhe pavarësisht se pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata Kushtetuese kërkuesit kanë paraqitur parashtrimet e tyre, të cilat duhet të merrnin përgjigje në seancë gjyqësore. Referuar vendimit nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë kishte detyrimin të kontrollonte respektimin e standardeve të së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të parimit të sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme dhe të barazisë para ligjit. Gjykatat nuk kanë pranuar të verifikojnë vërtetësinë e certifikatës së paligjshme të palës paditëse dhe pala e paditur në procesin gjyqësor (kërkuesit) nuk është dëgjuar në lidhje me argumentet e saj. Kjo certifikatë bie në kundërshtim me dispozitivin e vendimit të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka ndryshuar vendimin nr. 314/1994 të KKKP-së, i lënë në fuqi nga Gjykata, dhe me dispozitat e UKM-së nr. 3/1993 që përcaktojnë se afati i pagimit të kundërvleftës është 1 vit, ndërkohë që pagesa e dëmshpërblimit është bërë pas 11.5 vjetësh. Vendimi i formës së prerë i gjykatës së apelit, i lënë në fuqi nga Gjykata, nuk është respektuar në kundërshtim me nenin 451/a të KPC-së. Për shkak të mospagimit të kundërvleftës brenda afati prekluziv të përcaktuar nga UKM-ja nr. 3/1993, kërkuesit janë bërë bashkëpronarë në 37% të pronës, fakt që është përfundimtar dhe i sigurt juridikisht si nga pikëpamja ligjore, ashtu edhe kushtetuese. Sipas kërkuesve, gjykatat nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për verifikimin e origjinës së pronës, kufijve të saj, regjistrimit të paligjshëm të

sipërfaqes së truallit, si dhe nuk kanë pranuar mbrojtjen dhe prapësimin e tyre për abuzimin e paditësve në ngritjen e padisë, për kundërvajtjen e ASHK-së dhe shkeljen e procesit të rregullt. Vendimet gjyqësore nuk bazohen në provat e fashikullit gjyqësor dhe mungon hetimi i gjithanshëm i çështjes, si dhe vërtetimi i pronës së palës paditëse me dokument origjinal ose të prejardhur (kontratë), që as sot nuk disponon dokument pronësie për truallin ose për godinën.

32. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të kësaj Gjykate garantohej nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i këtyre vendimeve është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale. Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 20, datë 05.04.2023; nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Po kështu, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Kolegji vëren se në vendimin e saj nr. 16, datë 10.03.2016, Gjykata ka vlerësuar se “... pretendimi i kërkuarve për cenimin e njërit prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e kërkuarve, është i bazuar dhe duhet pranuar. Për sa u takon

pretendimeve të tjera të kërkuësve, që kanë të bëjnë me cenimin e sigurisë juridike, të së drejtës së pronësisë, të parimit të barazisë së armëve dhe mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata vlerëson të mos i analizojë ato, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar” (shih paragrafët 38 dhe 29 të vendimit nr. 16, datë 10.03.2016). Për rrjedhojë, Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për proces të rregullt në aspektin e paanshmërisë në gjykim, por nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në atë kërkesë, duke vlerësuar se për nga natyra e tyre dhe në funksion të rolit të Gjykatës së Lartë i takonte kësaj të fundit t'u jepte përgjigje.

35. Pas kthimit të saj për rigjykim, çështja e kërkuësve është rigjykuar nga Kolegji Civil, i cili, referuar dispozitave të reja procedurale që rregullojnë atë lloj gjykimi, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë rastet specifike për kalimin e saj në seancë gjyqësore, për rrjedhojë ka vijuar me shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit. Po kështu, rezulton se Kolegji Civil ka njoftuar palët për përbërjen e trupit gjykues dhe u ka dhënë atyre mundësinë të paraqisnin parashtrime me shkrim, fakt që rezulton jo vetëm nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë, por edhe nga parashtrimet e kërkuësve.

36. Në lidhje me pretendimet e parashtruara nga kërkuësit në rekurs, Kolegji Civil ka vlerësuar se ato nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 472 i KPC-së dhe se në themel të tyre kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave, çka nuk përfshihet në juridiksionin ligjor të asaj gjykate (shih paragrafin 24 të vendimit të Kolegjit Civil). Sipas tij, gjykatat e faktit kanë respektuar normat procedurale që mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit dhe nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale që të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve. Në drejtim të parimit të barazisë së armëve është vlerësuar se palëve u është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor (shih paragrafin 23, pikat i dhe ii, të vendimit të Kolegjit Civil).

37. Në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar, të lidhur me të drejtën e pronës private, Kolegji Civil ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, kanë bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me

dispozitat ligjore në fuqi, duke u dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve e prapësimeve të palëve mbi objektin e gjykimit, sipas nenit 296 të Kodit Civil, në drejtim të së drejtës së pronësisë së palës paditëse dhe posedimit të paligjshëm të të paditurve mbi pasurinë objekt rigjykimi. Po kështu, është vlerësuar se vendimet gjyqësore të gjykatave më të ulëta nuk bien në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe në zbatim të vendimit unifikues nr. 1/2009 gjykatat kanë hetuar e vlerësuar të drejtën e pronësisë së palës paditëse mbi pasurinë objekt gjykimi sipas titullit të pronësisë, duke mbajtur në konsideratë se regjistrimi ose certifikata e pronësisë e lëshuar nga ish-ZVRPP-ja nuk përbën titull pronësie, por një akt publikues dhe informues për të drejtën reale që subjekti gëzon mbi pasurinë. Kolegji Civil, më tej, ka vlerësuar se gjykatat kanë mbajtur në konsideratë dhe kanë zbatuar drejt fuqinë detyruese të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna midis palëve ndërgjyqëse, në zbatim të nenit 451/a të KPC-së (*shih paragrafin 23, pikat iii-v të vendimit të Kolegjit Civil*).

38. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka pasqyruar të dhënat e palëve, rrethanat e faktit dhe vendimmarrjet e gjykatave në atë proces, shkaqet e ngritura nga palët në rekurs, mbi të cilat ajo ka shqyrtuar çështjen, si dhe parashtrimet e paraqitura prej tyre në procesin e rigjykimit dhe u ka dhënë atyre përgjigje të arsyetuar, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, se përse këto shkaqe nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë rezulton të jetë logjik dhe pa kundërtënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Duke iu dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura nga kërkuesit në rekurs dhe në parashtrimet e tyre, Gjykata e Lartë u ka garantuar edhe të drejtën e aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit në kuptimin substancial. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë, për sa kohë që i ka marrë në shqyrtim dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesve, ka përmbushur edhe detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 16, datë 10.03.2016 i kësaj Gjykate. Vetëm fakti se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore nuk është i tillë që të vërë në dyshim vendimmarrjen e kundërshtuar të asaj gjykate.

39. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

40. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.